



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Shtojca 16

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data: 14.07.2020]

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik:** “D&E” SHPK dhe “SUMMER CONF. s.r.l” dhe “LOVERS s.r.l” dhe “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU”.

Adresa e përfaqësuesit të BOE-së ”D&E SHPK”: Rruga ”Milto Tutulani”, Pallati Alb Millenium, nr.6, Kati 1, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e kufizuar mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite.

Numri i referencës së procedurës: REF-31606-07-25-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve për Policinë e Shtetit, me fond total të marrëveshjes kuadër për 4(katër) vite: 2,800,347,570 (dymiliard e tetëqindmilion e treqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH) dhe me **shumatore limit të çmimeve për njësi:** 621,011 (gjashtëqind e njëzetë e një mijë e njëmbëdhjetë) Lekë (pa TVSH). **Afati kohor i ekzekutimit:** Brenda datës 1 Prill për artikujt e uniformës verore dhe brenda datës 1 Shtator për artikujt e uniformës dimërore. Përjashtimisht, afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruhet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë nga lidhja e kontratës së parë.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1) **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.** 3930583225
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi e ofruar: 133,480 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

2) **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik** “Kapko doo” dhe “Odjeca doo” dhe “Galko doo” dhe “Jelen professional doo” dhe “Galeb d.d” dhe “OpenTech consulting & Services” SHPK; (Emri i plotë i shoqërisë),respektivisht me NIPT: 49702093753; 59645137605; 46818705329; 18683136487; 74554924553; L41329019U (numri i NIPT-it);

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 446,667 (katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*;

- 3) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik:** "D&E SHPK" dhe "SUMMER CONF. s.r.l" dhe "LOVERS s.r.l" dhe "YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU". Respektivisht me NIPT: K71804001C; RO8145996; 00235470135; 9290313472;

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 319.966 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*;

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1) Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.** 3930583225
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*
- 2) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik** "Kapko doo" dhe "Odjeca doo" dhe "Galko doo" dhe "Jelen professional doo" dhe "Galeb d.d" dhe "OpenTech consulting & Services" SHPK; *(Emri i plotë i shoqërisë)*, respektivisht me NIPT: 49702093753; 59645137605; 46818705329; 18683136487; 74554924553; L41329019U **(numri i NIPT-it)**;

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. "GENC TAAHHUT GIYIM TEKSTIL":

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 11 të ofertës teknike, pasi dokumentat e paraqitur për çertifikata konformiteti EN ISO për çdo model këpuce (aty ku kërkohet), nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për më tepër ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues Fletë analiza/ Raporte testimi nga laboratorë të pavarur nga prodhuesi i lëndës së parë dhe produktit të gatshëm, për shollat e të gjitha llojeve të këpucëve (aty ku kërkohet). Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë kriter, përbën kusht për skualifikim.*
- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjurmën "b" të pikës 12 të ofertës teknike, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të pavarur nga prodhuesi i lëndës së parë dhe produktit të gatshëm, për disa artikuj tekstili dhe lëkure, e konkretisht: kostum dimëror për motoçiklistët; tekstili i kapeles për materialin bazë 100% lesh; doreza lëkure; tekstili i materialit të dytë bazë të pulovër e trikotuar me jakë V, me jakë të rrumbullaktë dhe me jakë gjysmë golf; tekstili i materialit të dytë të bluzës pambuku me jakë rrumbullake me mëngë të shkurtra dhe me mëngë të gjata,; tekstili i materialit të dytë të bluzës polo me mëngë të shkurtra dhe me mëngë të gjata,; tekstili i materialit të dytë të bluzës polo me mëngë të shkurtra për plazhe. Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë kriter, përbën kusht për skualifikim. Për më tepër, në aneksin 4, për artikujt nr.3, 4 dhe 5 (bluze polo me minge të shkurtra për punonjësit e policisë, bluze polo me minge të gjata për patrullat e policisë dhe bluze polo me minge të shkurtra për patrullat e policisë), është kërkuar që përbërja e materialit duhet të jetë 85%-90% pambuk + 10%-15% polipropilen, ndërsa ofertuesi ka paraqitur raport testimi ku rezulton se kjo kërkesë nuk plotësohet pasi përbërja e materialit të ofertuar është 50% pambuk + 50% poliester, jashtë parametrave të kërkuar. Gjithashtu, në aneksin 4, për artikujt 7, 8 dhe 9 (pulovër e trikotuar*

me jakë “V”, pulovër e trikotuar me jakë rrumbullake dhe pulovër me jakë gjysëm golf), është kërkuar që dendësia për materialin interlock duhet të jetë $30/26 \pm 2\%$, ndërsa ofertuesi ka paraqitur raport testimi ku rezulton se kjo kërkesë nuk plotësohet pasi rezultati për dendësinë e materialit të ofruar është $60/52$, jashtë parametrave të kërkuar. Për materialin llastik 1:1 dendësia e kërkuar është $35/44 \pm 2\%$, ndërsa referuar raportit të testimit të paraqitur nga ofertuesi dendësia rezulton të jetë ofruar $70/88$, jashtë parametrave të kërkuar.

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në germën “c” të pikës 12 të ofertës teknike, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur deklaratë nga prodhuesi i aksesorëve për përbërjen e materialeve të përdorura dhe cilësinë e tyre, sipas Specifikimeve Teknike, e konkretisht për: kopsat metalike (të mëdha, të vogla, xhemel), rripi i zi i kapelës, stema metalike dhe ornamentet e jakës, stema plastike, togëza metalike për rripat, kordona dekorativë për uniformën ceremoniale. Deklarata e paraqitur është lëshuar nga vet ofertuesi dhe jo nga kompanitë që pretendohen si prodhues të aksesorëve. Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë kriter, përbën kusht për skualifikim.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Kapko doo” dhe “Odjeca doo” dhe “Galko doo” dhe “Jelen professional doo” dhe “Galeb d.d” dhe “OpenTech consulting & Services” SHPK:

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 13 të ofertës teknike, pasi ditën e hapjes së procedurës nuk arriti të paraqesë mostrat / kampionet të disa prej artikujve që kërkohen të prokurohen, konkretisht: Kostumi i shërbimit civil për femra dhe meshkuj, Kostumi dimëror për motoçiklistët, Kostumi dimëror për patrullat, Pantallona verore për meshkuj, Këmishë bojëqielli me mëngë të gjata për femra dhe meshkuj, Këmisha ceremoniale me mëngë të gjata për meshkuj dhe femra në shërbimin civil, Pulovër e trikotuar me jakë “V”, Pulovër e trikotuar me jakë rrumbullake, Pulovër me jakë gjysëm golf, Kapele sportive dimërore, Dorashka motoçiklisti, Aksesorë reflektivë, Dorashka ceremoniale, Jelek operacional multifunksional, Jelek shpëtimi dhe Jelek prezantues. Kapela e uniformës verore për meshkuj dhe femra, Kapuç leshi. Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë kriter, përbën kusht për skualifikim.
- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 12 të ofertës teknike, pasi nuk ka dorëzuar skeda teknike, raport testimi / fletë analiza për të gjithë artikujt e përfshirë në Aneksin 1 - Kostume dhe Aneksin 2 - Këmisha. Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë kriter, përbën kusht për skualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: ”D&E” SHPK dhe “SUMMER CONF. s.r.l” dhe “LOVERS s.r.l” dhe “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU”, respektivisht me NIPT: K71804001C; RO8145996; 00235470135; 9290313472;

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 319,966 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë) dhe me pikë totale të marra 70 (shtatëdhjetë) pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.06.2020

Ankesa: Po.

Marrë përgjigje: vendim i KSHA-së me nr.1174/2 date 29.06.2020;

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM